

UDHËZIM
Nr.8, datë 26.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E BILETAVE,
SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË PËRDORIM**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13 pika 2 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shtypja e biletave të lojërave të fatit kryhet nga vetë shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e lojërave të fatit, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. Ministri i Financave, me propozim të NJMLF-së, miraton çdo biletë të re, që hidhet në qarkullim nga organizatori i lojërave të fatit. Për këtë qëllim, organizatori paraqet pranë NJMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për miratim të biletës, shoqëruar me modelin e biletës së propozuar nga organizatori;

b) Kontratën e lidhur me prodhuesin e biletës;

c) Detaje teknike të lojës dhe biletës;

3. Bileta e propozuar nga organizatori duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Emrin e shoqërisë;

b) Të përmbajë nënshkrimin e “Miratuar nga Ministria e Financave”;

c) Çmimin e biletës në lekë (përjashtuar biletat ku çmimi përcaktohet sipas rastit);

d) Numri serial i biletës (për biletat e lojës së fatit “bingo” duhet të jetë gjithmonë progresiv);

e) Elementi i sigurisë së biletës, përfshirë numrin serial progresiv;

f) Rregullorja e lojës me çmimet përkatëse për fituesin (për biletat e lotarisë së çastit).

4. Biletat shtypen në një shtypshkronjë të akredituar brenda dhe jashtë vendit.

5. Në kontratën me shtypshkronjën do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, data e dorëzimit të biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë.

6. Organizatori depoziton pranë NJMLF-së, përpara hedhjes në qarkullim të biletës për kategorinë e lojës “lotari me fitim në çast”, CD me kodet e sigurisë dhe çmimet fituese të biletave si të prodhuara nga shtypshkronja, me të cilën organizatori ka lidhur kontratën. Kjo CD hapet vetëm në përfundim të lojës dhe në prani të organizatorit.

7. Organizatori është i detyruar të depozitojë në NJMLF regjistrin e shpërndarjes së biletave, sipas sallave apo pikave të shitjes në të gjithë territorin e vendit përpara hedhjes në qarkullim të biletës dhe të njoftojë në vazhdimësi për çdo parti të re furnizimi në këto pika shitjeje.

8. Organizatori i lotarisë së çastit/me shorte është i detyruar të publikojë në të gjitha pikat e shitjes së biletave;

a) serinë e plotë të biletave të hedhura në qarkullim në të gjithë territorin e vendit;

b) rregulloren e lojës.

9. Organizatori i lojës njofton NJMLF-në çdo 6 muaj mbi xhiron e realizuar nga shoqëria, bazuar mbi shitjen e biletave; sasinë e shitur të biletave dhe çmimet fituese, si dhe derdhjen e detyrimeve tatimore, sipas ligjit.

10. Asgjësimi i biletave bëhet vetëm me miratim të Ministrit të Financave.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode